



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7408 Nr. i faq/Br.str/No.pg 43
Data/Datum/Date 25 / 5 / 2020
RAHOVEC / ORAHOVAC

**PROCESVERBAL NGA DËGJIMET
BUXHETORE
PROCESVEBAL NGA TAKIMI ME
KRYETARË TË FSHATRAVE DHE
LAGJEVE URBANE**

20.05.2026

Procesvebal nga takimi me kryetarë të fshatrave dhe lagjeve urbane.

Blertë Gashi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm, drejtor për Buxhet dhe Financa, anëtarë të grupit punues dhe ju qytetarë të pranishëm. Ky është cikli i parë dhe takimi i parë i dëgjimeve buxhetore për përgatitjen e kornizës afatmesme buxhetore. Ky proces shënon fillimin e konsultimeve publike dhe bashkëpunimit institucional për planifikimin e prioritetëve dhe projekteve që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve. Qëllimi i dëgjimeve është që përmes diskutimeve tuaja të identifikohen prioritetet kryesore për investime dhe shërbime. Çdo propozim dhe çdo kërkesë e juaja do të trajtohet nga grupi punues gjatë hartimit të dokumenteve buxhetore.

Afrim Limani: Të nderuar pjesëmarrës! Më lejoni që në cilësinë e drejtorit për Buxhet dhe Financa t'ju shpjegojë buxhetin komunal për vitin 2027. Më datë 16 maj ka ardhur Qarkorja e Parë Buxhetore, që është dokument i rëndësishëm financiar i përcaktuar me Ligj të Financave Publike dhe Përgjegjësi dhe e përcakton hisen buxhetore për çdo komunë të Republikës së Kosovës. Sipas këtij dokumenti, buxheti i komunës së Rahovecit për vitin 2027 është 21.704.000€ dhe ndahet sipas programeve. Në administratë: 9.946.000 dhe kur e bëjmë një krahasim me vitin aktual, kemi rritje të buxhetit prej 778.000€. Në arsim: 634.305 dhe kur bëjmë krahasim me vitin 2026, kemi një zvogëlim prej 660.000. Në shëndetës: 2.323.000 dhe kur bëjmë krahasim me vitin aktual, kemi një rënie prej 36.000. E falënderoj ekipin tim të financave, që brenda një afati shumë të shkurtër kemi bërë një punë shumë intenzive. Në kategori ekonomike, përafërisht buxheti duhet të jetë kështu: Pozicioni i pagave: 12.919.000€, mallra dhe shërbime 2.821.000, shpenzime komunal 440.00, subvencione 1.000.000 dhe investime kapitale 4.523.000, 374.000 euro më pak në vitin 2027 se sa në vitin 2026. Të nderuar pjesëmarrës, si rezultat i kontratës kolektive jemi në një krizë financiare, krejt kjo si pasojë e kontratës kolektive, e cila deri më tani i ka tërhequr 3.5 milionë. Buxheti i arsimit gjithashtu ka ndikuar që ulje të buxhetit, sepse mungesa e nxënësve llogaritet sipas formulës. Drejtpërdrejt në zvogëlimin e buxhetit është edhe numri më i vogël i popullsisë, pra jemi 14.000 banorë më pak se sa në regjistrimin e parafundit. Ju ftoj t'i paraqitni kërkesat dhe pyetjet e juaja rreth buxhetit për vitin 2027.

Selajdin Gashi: Jam përfaqësues i fshatit Çifllak! Ju falënderoj të gjithëve për punën që e keni bërë në fshatin tonë, por ne kemi përsëri kërkesa. Në Çifllak është punuar një projekt i kanalizimeve, mirëpo është ndërprerë në gjysmë, si dhe besoj që do të vazhdojë. Një pjesë e vogël e fshatit kemi nevojë për kanalizim të ujërave të zeza. Kemi nevojë për disa trotuare, që fëmijët gjatë ecjes për në shkollë të mos rrezikohen nga veturat që kalojnë aty. Kemi nevojë edhe për disa rrugë të fshatit që kanë mbetur në gjendje të papërfunduar. Problem kryesor është deponia e materialeve të ngurta, e cila pastrohet nga komuna, por përsëri mbushet.

Mirsad Qehaja: Jam kryetar i këshillit të fshatit Retijë e Poshtme! Në mandatin e kaluar, në fshatin tonë janë kryer shumë punë, mirëpo kërkesat e komunitetit nuk ndalen. Të gjitha kërkesat

janë të deponuara, do të ndalem vetëm te dy që janë pak më emergjente. Shkolla e fshatit është në gjendje të mjerueshme dhe ka gjasa që në shtator, prindërit të mos na lëshojnë fëmijët e tyre aty. Ajo shkollë nuk ka as kushte minimale. Tualetet e shkollës janë jashtë objektit, para shembjes dhe janë me gropë septike. Kërkesë urgjente është gropa septike e kanalizimit, e cila është e mbushur dhe jashtë funksionit. Nuk e di nëse ekziston ndonjë marrëveshje me K.R.U Gjakovën, për pastrimin e saj. Kërkesa tjetër ka të bëjë me ndërtimin e një objekti përcjellës jashtë fushës sportive. Një kërkesë tjetër, që e kam bërë edhe herën e kaluar ka të bëjë me idenë e pagesës së kryetarëve të këshillave të fshatrave, të paktën shpenzimet. Nuk e di nëse e keni paraparë me buxhet. Duke u bazuar në udhëzim administrativ, personalisht e kam bërë një kërkesë në lidhje me këtë çështje. I ftoj të gjithë kryetarët që të bëjnë kërkesa.

Mensur Gashi: Jam kryetari i fshatit Sapniq! Një kërkesë për një rreth-rrotullim që e kërkojmë ka kohë që 6-7 vite. Në atë pikë që i lidh tri fshatra kemi probleme të theksuara në komunikacion. Kemi nevojë gjithashtu për kanalizim. I kemi 7 rrugë që kanë nevojë të kubëzohen. Së fundmi, Keds-i ka punuar diçka në fshat dhe asnjë dritë nuk punon. Këto janë disa prej kërkesave më urgjente.

Ruzhdi Kastrati: Jam përfaqësues i fshatit Hoçë e Vogël. I kam bërë disa kërkesa për rregullimin e disa rrugëve fushore, në të cilat kalueshmëria ka qenë e vështirë. Si fshat, duke u bazuar në atë që komuna nuk ka intervenuar, kemi ndërhyrë personalisht dhe e kemi rregulluar një rrugë. Nuk e di, por në fshatin tonë puna e ekzekutivit ka qenë zero. Si kërkesë tjetër e kemi rregullimin e trotuareve dhe rregullimi i përrockës së fshatit. Si kërkesë emergjente është rregullimi i rrugëve fushore.

Përparim Krasniqi: Përshëndetje të gjithë! Sa i përket rregullimit të përrockës së fshatit. Në vendimin e fundit të ministrisë së linjës është ndaluar me ligj që përrockat të betonizohen. Për këtë arsye tani e tutje nuk guxojmë t'i betonizojmë përrockat, por duhet të gjejmë alternativa të tjera. Sa i përket kërkesave që drejtohen në drejtorinë e Shërbimeve Publike, çdo kërkesë është valide për një vit dhe vitin tjetër nëse nuk është realizuar, e njëjta duhet të bëhet përsëri.

Mensur Gashi: Drejtor, të njëjtën kërkesë e bëjmë për çdo vit.

Afrim Limani: Format i takimit është që ta shpjegoj buxhetin dhe t'ju marrim kërkesat e juaja. Grupi punues do të kujdeset edhe për procesverbal dhe për të gjitha shqetësimet e tjera.

Procesmbajtës: Skender Hamza